



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**  
**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË**  
**ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KUKËS**

**N J O F T I M**

***PËR KANDIDATËT APLIKANTË NË PROVIMIN E SHTETIT NË PROFESIONIN E  
RREGULLUAR TË MËSUESIT SEZONI XX***

Për të gjithë kandidatët aplikantë për pjesëmarrje në provimin e shtetit në profesionin e rregulluar të Mësuesit, ju bëjmë me dije se aplikimi do të kryhet online përgjatë periudhës **7 – 14 Prill 2025**, duke përdorur shërbimin “Aplikim për provim shteti” në platformën e-Albania.

Gjatë aplikimit online për pjesëmarrje në provimin e shtetit, kandidati duhet të ngarkojë dokumentet e mëposhtme:

1. *Diplomën/diplomat e programit të studimeve për profesionin e mësuesisë;*
2. *Dëshminë e pjesëmarrjes dhe përfundimit me sukses të praktikës profesionale të lëshuar nga institucioni kompetent për kryerjen e praktikës, ku përcaktohet edhe kohëzgjatja;*

*\*Në raste të caktuara: Vërtetimin për njohjen dhe njësimin e diplomës në rast se studimet janë përfunduar jashtë shtetit; Dokumentacion të lëshuar nga institucioni përgjegjës për arkivat që provon lëshimin e diplomës apo dokumentit të barasvlershëm me të, të fituar nga institucioni i arsimit të lartë të mbyllur. Dokumenti që vërteton e vlefshmërinë e diplomës/diplomave të lëshuara.*

3. *Vetëm pas njoftimit të pranimit nga DRAP, faturën e pagesës së kryer për llogari të QSHA-së, e cila duhet të ngarkohet në sistem në fushën që shfaqet pas vendosjes së kodit të gjurmimit dhe kodit të sigurisë, **brenda 72 orëve nga njoftimi i pranimit nga DRAP.***

Pas ngarkimit në sistem të pagesës, lutemi që kandidatët të qëndrojnë në pritje të email-it të pranimit nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.

Lidhur me aplikimin e shtetasve të huaj, lutemi që pasi të zgjidhet shërbimi “Aplikim për provim shteti” në platformën e-Albania, të zgjidhet opsioni “shtetas i huaj” dhe të plotësohen me saktësi fushat e kërkuara.

Kandidatët do të njoftohen në çdo fazë të aplikimit nëpërmjet postës elektronike si dhe portalit e-Albania në rubrikën Hapësira ime–Mesazhete mia. Gjithashtu, me anë të kodit

unik të gjurmimit mund të gjurmojnë në çdo kohë statusin e aplikimit.

- Kandidati duhet të paraqitet pranë QSHA-së 30minuta përpara orarit të publikuar dhe të jetë i pajisur me:
  - Mjet identifikimi(Kartë identiteti osePasaportë, dokumenti origjinal);
  - Kandidati gjatë zhvillimit të provimit duhet të zbatojë rregullat e mëposhtme:
  - Ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve apo mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
  - Ndalohet komunikimi me kandidatët e tjerë gjatë zhvillimit të provimit deri në marrjen e deklaratës së rezultatit;
  - Ndalohet lëvizja përtej vendit të përcaktuar për zhvillimin e provimit;
  - Ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit.

Kandidatët të cilët rezultojnë të suksesshëm në provimin e shtetit, menjëherë pas përfundimit të provimit, kanë të drejtë t'i nënshtrohen testimit të informatizuar të mësuesit, për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar.

Programet orientuese të provimit të shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit dhe fondet e pyetjeve sipas profileve, gjenden të publikuara në faqen zyrtare të QSHA [www.qsha.gov.al](http://www.qsha.gov.al).

Programet orientuese të testimit të informatizuar të mësuesit(Portali) për kandidatët të cilët duan të punësohen në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, gjenden të publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar [www.ascap.edu.al](http://www.ascap.edu.al).

Kalendari i zhvillimit të sezonit dhe orari i provimit për çdo kandidat, do të publikohen në vijim në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore [www.qsha.gov.al](http://www.qsha.gov.al). Orari i pjesëmarrjes në provim do të jetë i përcaktuar dhe nuk do të ketë ndryshime përtej orarit të publikuar.

Ju urojmë suksese!

**DREJTOR**

**KRESHNIK GËRBOLLI**